

Data 06.08.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburanti (Gasoil dhe Benzinë) për Automjete” ndarë në Lote:

Loti i I-rë: “Blerje gasoil për automjete”,

Loti i II-të: “Blerje benzinë për automjete”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09100000-0, Karburante

VLERA E FONDIT LIMIT: 48,764,200 (dyzet e tetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind) Lekë, pa TVSH.

Në Euro: 523,221.03 (pesëqind e njëzetë e tre mijë e dyqind e njëzetë e një pikë zero tre) euro, pa TVSH.

Sipas kursit zyrtar të këmbimit 1 (një) EURO këmbëhet me 93.2 Lekë, datë 06.08.2026.

1. Loti i I-rë: “Blerje gasoil për automjete”, me fond limit 39,867,000 (tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) Lekë, pa TVSH.

Në Euro: 427,757.5 (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë pesë) euro, pa TVSH.

2. Loti i II-të: “Blerje benzinë për automjete”, me fond limit 8,897,200 (tetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) Lekë, pa TVSH.

Në Euro: 95,463.5 (nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesë) euro, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Posta Shqiptare sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I I-RË: “BLERJE GASOIL PËR AUTOMJETE”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të plotësojë kërkesën për xhiron vjetore në raport me vlerën e përlllogaritur mbi shumatoren e fondeve limit të loteve për të cilat konkurron. Në këtë rast, vlera e xhiros së realizuar në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kërkuar për shumatoren e loteve për të cilat paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij ekonomik dhe financiar për realizimin me sukses të të gjitha loteve).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është

brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.

(Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të dyja lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të dyja loteve ku aplikon.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 . Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku në Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë **(të treja së bashku)** të kenë minimumi 5 (pesë) stacione, si dhe në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktor, dhe konkretisht - **Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Tepelenë, Përmet, Korçë, Pogradec, Kolonjë, Elbasan, Librazhd, Shkodër, Koplik, Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Dibër, Mirditë, Kukës, Tropojë dhe Has**, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë noteriale qeraje ose furnizimi (bashkëpunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB). Këto stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve të cituara më lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Licence/Autorizim të lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë, Leje mjedisore e tipit B ose C sipas legjislacionit, të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (ndryshuar). Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe intineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Për vetë shpërndarje e aktivitetit të “Posta Shqiptare” sh.a. ku Zyrat qendrore të Shoqërisë janë në Qendër të Tiranë, një pjesë e aktivitetit realizohet në ambjentet pranë ish Kinostudios, një pjesë e aktivitetit ushtrohet në Shark (Fushë Prezë) afër Vorës, ofrimi i shërbimeve të zyrave postare në të gjithë territorin e Tiranës ku ofrohen shërbime postare në 60 (gjashtëdhjetë zyra postare) që mbulohen me mjete motorike (automjete dhe motoçikleta) ngarkesa e trafikut në Tiranë si dhe fakti që çdo ditë në orët e para të mëngjesit nga Filiali Qendra Tranzite nisën për në skajet më fundore të vendit në të gjithë Shqipërinë automjet e postës për transportin e dërgesave postare, e bën të nevojshme që operatori që ofron këtë shërbim të ketë disponimin e një numri relativisht të lartë të pikave të karburantit në territorin e Tiranës që përfshinë Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë (të treja së bashku). Edhe nëse i referohesh pikave të karburanteve që ushtrojnë aktivitetin në Tiranë lehtësisht mund të dallosh një numër të lartë operatorësh që ushtrojnë aktivitetin me një numër relativisht të lartë pikash si Elda, Dako, Kastrati, Gega, Velaj, Gazheli, Bolv Oil, ESP&OI, ALPET etj. Po kështu edhe nëse i referohemi kriterit, nuk është kërkuar që pikat e karburantit të jenë në pronësi por të jenë të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë noteriale qeraje ose furnizimi (bashkëpunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB).

Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a. është një Subjekt që ka një organizim të centralizuar e cila përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme, nga Filialet që shtrihen në të gjitha Prefekturat duke shtuar edhe Filialet Lushnjë dhe Sarandë (që nuk janë qendër prefekturë). Pra kemi 15 (pesëmbëdhjetë

Filiale dhe kemi Degët Postare që janë në çdo qendër administrative rrethi si dhe Filialin e Qendra Tranzite.

Sejcili Filial dhe degë postare ka një normë karburanti por sasia më e madhe e konsumit të karburanteve konsumohet nga mjetet e Filialit Qendra Tranzite, të cilat nisen çdo ditë nga kjo qendër për të dërguar objektet postare, deri në pikat më fundore (zyrat postare) të Republikës së Shqipërisë. Po kështu nuk është se një automjet bën të njejtin destinacion çdo ditë pasi automjetet alternohet dhe një ditë shkon një automjet dhe ditë tjetër shkon një automjet tjetër të cilët nuk kanë as të njejtën normë konsumi karburanti për vetë vitin e prodhimit të automjetit.

Për vetë distancat e gjata që kryejnë këto mjete transporti, si dhe rastet e lëvizjes së mjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë, për AK-në është e pamundur që të pasqyrohet sasia dhe grafiku i lëvrimit i pikave të veçanta.

Referuar sa më sipër, për AK-në kërkesa që ***“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku në Bashkit Tiranë, Kamëz, Vorë (të treja së bashku) të kenë minimumi 5 (pesë) stacione të tregimit me pakicë të karburanteve është*** në përpjesëtim dhe e lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës pasi mbi 40% e aktivitetit të Posta Shqiptare sh.a. realizohet në territorin e Tiranës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet deklarojë që stacionet e tregimit me pakicë të karburanteve ku do të kryhet furnizimi, të cilat janë në marrëveshje me të tretë (kontrata furnizimi), të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi si dhe detyrimisht të jenë të pajisura me Sistem Elektronik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Meqënëse kontrata e parashikuar ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh, Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon të sigurohet për furnizimin e produktit objekt prokurimi në vazhdimësi, me cilësinë e kërkuar në DST.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Meqënëse kontrata e parashikuar ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh, Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon

të sigurohet për furnizimin e produktit objekt prokurimi në vazhdimësi, me cilësinë e kërkuar në DST.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete analiza të lëshuar nga ISHTI (për ato zëra të cilat është i akredituar), brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës sipas standarteve ne fuqi;

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.*

2.3.6 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim. Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

1. Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targon e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
2. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
3. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në karten elektronike të personalizuar me targon e mjetit në lëng në depozitën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
4. Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepërmjet karteve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor.
5. Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 **“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qevërisjes së përgjithshme”**, Operoret ekonomik pjesëmarres duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepërmjet kartës elektronike.
6. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja

e kartave elektronike të personalizuar me targen e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofroje edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.

7. Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofroje edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me struktura piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.

8. Disponimi/Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mesipër, do të demonstron nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani të anetarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Është kërkuar që operatori ekonomik të vetëdeklarojë se përmbush kërkesat e mësipërme pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike dhe do të eliminohet mundësia e abuzimit me karburantin e automjeteve.

Në të gjitha rastet kur Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike i është referuar standardeve ISO, EN, DIN, SSH, UNI ose standardeve të tjera ndërkombëtare, do të pranohen edhe standarde ose specifikime teknike ekuivalente, të provuara nga operatori ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo referencë ndaj standardeve të sipërcituara do të konsiderohet e shoqëruar me fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8 të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake,*

*në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.***

*Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike***

LOTI I II-TË “BLERJE BENZINË PËR AUTOMJETE”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të plotësojë kërkesën për xhiron vjetore në raport me vlerën e përllogaritur mbi shumatoren e fondeve limit të loteve për të cilat konkurron. Në këtë rast, vlera e xhiros së realizuar në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kërkuar për shumatoren e loteve për të cilat paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij ekonomik dhe financiar për realizimin me sukses të të gjitha loteve)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a)Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të provojë se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se vlera e kërkuar për shumatoren e loteve për të cilat

paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij teknik për realizimin me sukses të të gjitha loteve ku aplikon)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 19 % të vlerës **e fondit limit të lotit për të cilët konkuron**, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 . Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku në Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë **(të treja së bashku)** të kenë minimumi 5 (pesë) stacione, si dhe në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktor, dhe konkretisht - **Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Tepelenë, Përmet, Korçë, Pogradec, Kolonjë, Elbasan, Librazhd, Shkodër, Koplik, Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Dibër, Mirditë, Kukës, Tropojë dhe Has**, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë noteriale qeraje ose furnizimi (bashkëpunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB). Këto stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve të cituara më lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Licence/Autorizim të lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë, Leje mjedisore e tipit B ose C sipas legjislacionit, të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (ndryshuar). Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Për vetë shtirrje e aktivitetit të “Posta Shqiptare” sh.a. ku Zyrat qendrore të Shoqërisë janë në Qendër të Tiranë, një pjesë e aktivitetit realizohet në ambjentet pranë ish Kinostudios, një pjesë e aktivitetit ushtrohet në Shark (Fushë Prezë) afër Vorës, ofrimi i shërbimeve të zyrave postare në të gjithë territorin e Tiranës ku ofrohen shërbime postare në 60 (gjashtëdhjetë) zyra postare) që mbulohen me mjete motorike (automjete dhe motoçikleta) ngarkesa e trafikut në Tiranë si dhe fakti që çdo ditë në orët e para të mëngjesit nga Filiali Qendra Tranzite nisën për në skajet më fundore të vendit në të gjithë Shqipërinë automjet e postës për transportin e dërgesave postare, e bën të nevojshme që operatori që ofron këtë shërbim të ketë disponimin e një numri relativisht të lartë të pikave të karburantit në territorin e Tiranës që përfshinë Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë (të

treja së bashku). Edhe nëse i referohesh pikave të karburanteve që ushtrojnë aktivitetin në Tiranë lehtësisht mund të dallosh një numër të lartë operatorësh që ushtrojnë aktivitetin me një numër relativisht të lartë pikash si Elda, Dako, Kastrati, Gega, Velaj, Gazheli, Bolv Oil, ESP&OI, ALPET etj. Po kështu edhe nëse i referohemi kriterit, nuk është kërkuar që pikat e karburantit të jenë në pronësi por të jenë të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë noteriale qeraje ose furnizimi (bashkëpunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB).

Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a. është një Subjekt që ka një organizim të centralizuar e cila përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme, nga Filialet që shtrihen në të gjitha Prefekturat duke shtuar edhe Filialet Lushnjë dhe Sarandë (që nuk janë qendër prefekturë). Pra kemi 15 (pesëmbëdhjetë) Filiale dhe kemi Degët Postare që janë në çdo qendër administrative rrethi si dhe Filialin e Qendra Tranzite.

Sejçili Filial dhe degë postare ka një normë karburanti por sasia më e madhe e konsumit të karburanteve konsumohet nga mjetet e Filialit Qendra Tranzite, të cilat nisen çdo ditë nga kjo qendër për të dërguar objektet postare, deri në pikat më fundore (zyrat postare) të Republikës së Shqipërisë. Po kështu nuk është se një automjet bën të njëjtin destinacion çdo ditë pasi automjetet alternohen dhe një ditë shkon një automjet dhe ditë tjetër shkon një automjet tjetër të cilët nuk kanë as të njëjten normë konsumi karburanti për vetë vitin e prodhimit të automjetit.

Për vetë distancat e gjata që kryejnë këto mjete transporti, si dhe rastet e lëvizjes së mjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë, për AK-në është e pamundur që të pasqyrohet sasia dhe grafiku i lëvrimit i pikave të veçanta.

Referuar sa më sipër, për AK-në kërkesa që **“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku në Bashkit Tiranë, Kamëz, Vorë (të treja së bashku) të kenë minimumi 5 (pesë) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve është** në përpjesëtim dhe e lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës pasi mbi 40% e aktivitetit të Posta Shqiptare sh.a. realizohet në territorin e Tiranës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet deklarojë se stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve ku do të kryhet furnizimi, të cilat janë në marrëveshje me të tretë (kontrata furnizimi), të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi si dhe detyrimisht të jenë të pajisura me Sistem Elektronik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Meqënëse kontrata e parashikuar ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh, Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon të sigurohet për furnizimin e produktit objekt prokurimi në vazhdimësi, me cilësinë e kërkuar në DST.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Meqënëse kontrata e parashikuar ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh, Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon të sigurohet për furnizimin e produktit objekt prokurimi në vazhdimësi, me cilësinë e kërkuar në DST.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete analiza të lëshuar nga ISHTI (për ato zëra të cilat është i akredituar), brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

2.3.6 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim. Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

1. Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targon e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
2. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
3. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në karten elektronike të personalizuar me targon e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
4. Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepërmjet karteve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor.

5. Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 **“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qevërisjes së përgjithshme”**, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

6. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.

7. Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.

8. Disponimi/Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara mesipër, do të demonstrohen nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani të anetarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, nenin 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*. Është kërkuar që operatori ekonomik të vetëdeklarojë se përmbush kërkesat e mësipërme pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike dhe do të eliminohet mundësia e abuzimit me karburantin e automjeteve.

Në të gjitha rastet kur Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike i është referuar standardeve ISO, EN, DIN, SSH, UNI ose standardeve të tjera ndërkombëtare, do të pranohen edhe standarde ose specifikime teknike ekuivalente, të provuara nga operatori ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo referencë ndaj standardeve të sipërcituara do të konsiderohet e shoqëruar me fjalët **“ose ekuivalenti i tij/saj”**.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8 të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.*”

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”, **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës

Specifikimet teknike të procedurës me objekt “**Blerje Karburanti (Gasoil dhe Benzinë) për Automjetet**” janë hartuar mbi bazën e Urdhrit nr. 33, datë 20.04.2026, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “**Për Prokurimin Publik**”, të ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, të ndryshuar. Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat teknike dhe cilësore të karburanteve objekt prokurimi, duke garantuar cilësinë e kërkuar, përshtatshmërinë për përdorim në automjetet e Autoritetit Kontraktor dhe përmbushjen e funksioneve të kërkuara.

Kërkesat teknike janë hartuar bazuar në nevojat reale të Autoritetit Kontraktor për furnizimin me **gasoil dhe benzinë** të automjeteve të flotës, si dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi për cilësinë e karburanteve, përkatësisht **SSH/EN 590:2022 ose ekuivalent** për Gasoil dhe **SSH/EN 228:2022 ose ekuivalent** për benzinën pa plumb. Specifikimet teknike janë hartuar duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar vetëm kërkesat e nevojshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në rastet kur janë referuar standarde teknike **SSH, EN, ISO, DIN, UNI ose standarde të tjera ndërkombëtare**, do të pranohen edhe standarde ose specifikime teknike ekuivalente, të provuara nga operatori ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësia e Prokurimit: